



EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.2, Mars - Maj 2011

Në fokus

Lëvizja pa viza deri tani: Kush udhëton dhe për cilat arsye?

Pak muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit për liberalizimin e vizave (15 dhjetor 2010) dhe vetëm pak ditë përpara publikimit të Raportit të vlerësimit të Komisionit European mbi ecurinë e deritanishme të kësaj lëvizjeje (9 qershor 2011), EMA publikon gjetjet e sondazhit të kryer në shkallë kombëtare mbi impaktin e lëvizjes pa viza tek qytetarët shqiptarë. Nëpërmjet një kampioni prej 1200 të intervistuarish i cili merr parasysh karakteristikat socio-demografike të popullsisë së Shqipërisë (duke iu referuar të dhënave të INSTAT 2006, treguesit sipas qarqeve), studimi eksploron efektin e rregullave më fleksibël të udhëtimit (lëvizjes pa viza) në hapësirën Shengen mbi prirjen për udhëtim/migrim të përkohshëm ose të përhershëm. Ky studim nuk shqyrton marrëdhënien mes të ardhurave individuale dhe udhëtimit/migrimit.

Qëllimi i këtij studimi është që, nëpërmjet evidentimit të prirjes për të udhëtuar/migruar të popullsisë si dhe konturimit të profilit socio-ekonomik dhe gjeografik të personave që e përdorin lëvizjen pa viza, të vërë në pah impaktin e saj mbi remitancat, tregun e punës apo fusha specifike të ekonomisë si turizmi, biznesi, etj.

...vijon në faqen 2 >>

“Koha e artë e fotografisë shqiptare” mbërrin në Bruksel

Sipas organizuesve të ekspozitës fotografike nga arkivi i familjes Marubi, hapur nga 17 shkurti deri në 27 mars në muzeun Botanique në Bruksel “Edhe pse e panjohur në perëndim, fotografia shqiptare mbetet një nga koleksionet më të pasura të fotografisë në Ballkan dhe ndoshta ndër më të mëdhatë në Evropë”.

Historia e fotografisë shqiptare fillon me Pjetër Marubin, një italian garibaldian i arratisur i cili u strehua në Perandorinë Osmane dhe më konkretisht, në qytetin e Shkodrës. Ai ishte një pionier i vërtetë, i cili hapi studion e parë fotografike në Shqipëri në vitin 1850.

...vijon në faqen 3 >>



Të rinjtë shqiptarë duhet të bëhen pjesë e demokracisë!



Ambasadori i Vendeve të Ulëta në Shqipëri, SH.T. Z. Van Den Dool

Në vitin 1988, në Brazil u mbajtën zgjedhjet vendore. Njëri nga kandidatët, i cili aspironte të bëhej Kryetar i Bashkisë së Rio De Zhaneiros, njihej me emrin Tiao. Megjithëse ai zhvilloi një fushatë elektorale të suksesshme, në fund Tiao nuk ishte fituesi. Gjithsesi, ai arriti të fitonte rreth 400,000 vota, duke u renditur i treti. Kjo ishte një arritje impresionuese në çdo aspekt. Sidomos nëse do të kishit parasysh që Tiao nuk ishte një politikan i zakonshëm, por në fakt ishte një shimpanze që jetonte në kopshtin zoologjik të Rio de Zhaneiros. Një grup njerëzish kishin menduar të lançonin kandidaturën e Tiaos, sepse ata ishin të lodhur nga politikanët që

...vijon në faqen 4 >>

Lëvizja pa viza deri tani: Kush udhëton dhe për cilat arsye?

...vijon nga faqja 1 >>


Gjetjet kryesore të sondazhit:

Liberalizimi i vizave duket se ndikon në masë të gjerë pozitivisht në vendimin e qytetarëve për të udhëtuar

Më shumë se gjysma e shqiptarëve do të ndërmerrenin një udhëtim në hapësirën Shengen menjëherë pas hyrjes në fuqi të vendimit për liberalizimin e vizave. Efekti psikologjik i heqjes pengesave dhe kufizimeve në lëvizje, duket se është i konsiderueshëm dhe, së bashku me faktorë si rrjeti i gjerë social dhe familjar, rritja e nivelit të të ardhurave, janë faktorë që nxisin prirjen për të udhëtuar jashtë vendit.


Qytetarët duket se kanë ndërmend ta përdorin liberalizimin e vizave kryesisht për "qëllimet e duhura"

Sondazhi vë në pah se qytetarët po e përdorin lëvizjen pa viza kryesisht për qëllimet për të cilat ishte parashikuar si turizëm, 47%; vizita familjare, 17%; studime, 11%; etj. dhe vetëm 12% janë shprehur se do ta përdorin liberalizimin për punësim. Kjo tregon se puna e kryer nga aktorët e ndryshëm për informimin e qytetarëve mbi kushtet e lëvizjes pa viza ka pasur një impakt të kënaqshëm.



Efekti i liberalizimit të vizave mbi planet e qytetarëve për migrim afatgjatë ose të përhershëm duket modest.

Qytetarët duket se do të përfitojnë nga liberalizimi i vizave kryesisht për udhëtime afatshkurtra. Prirja për të ndërmarrë udhëtime afatshkurtra (0-3 muaj) shënon një rritje prej 11%.




Prirja për të udhëtuar/migruar përpara dhe pas LV, sipas llojeve të udhëtimit/migrimit

Individët rreth moshës 25-30 vjeç janë pjesëmarrësit më aktivë në çdo lëvizje apo migrim të popullsisë. Me liberalizimin e vizave, vizitat afatshkurtra (0-3 muaj) shënojnë një rritje

interesante (10%) në kategorinë e moshës prej 50-59 vjeç, një prirje e lartë që zhduket në modelet e tjera të migrimit (afatgjatë ose të përhershëm). Këta qytetarë janë pjesërisht prindër që vizitojnë fëmijët me familjet e tyre në emigrim,

A do të ndërmerrenin një udhëtim në një vend të Shengenit menjëherë pas LV?



Qytetarët e zonave urbane kanë prirje shumë të lartë për të udhëtuar, 74 %, krahasuar me ata të zonave rurale, 26%, fakt ky i cili mund të shpjegohet me kushtet më të mira ekonomike të cilat mundësojnë udhëtimin.

Qytetarët e punësuar dhe studentët duket se janë përfituesit kryesorë të lëvizjes pa viza, përkatësisht me 54% dhe 21 %.

Niveli dhe stabiliteti i të ardhurave duket se ndikon në mënyrë domethënëse në vendimin për të ndërmarrë udhëtime afatshkurtra në zonën e Shengenit. Siç vë në dukje sondazhi, pjesa dërrmuese e udhëtarëve janë të angazhuar në sektorë me të ardhura më të larta dhe/ose të qëndrueshme si sektori privat, 53% dhe sektori publik, 38%. Vetëm 9% e udhëtarëve është janë të angazhuar në bujqësi.



me shumë të ngjarë që t'i mbështesin në kujdesin e fëmijëve ose lloj tjetër të punës në familje. Ky lloj kontingjenti duket se do të jetë me avantazh për vendet pritëse, duke nxitur rritjen e pjesëmarrjes në punë dhe produktivitetin e emigrantëve të përhershëm, ndoshta reduktimin e kostove të tyre (të tilla si pagesa për kujdesin e fëmijëve). Për rrjedhojë, Shqipëria mund të përjetojë një rënie të lehtë e papunësisë, por ajo **mund të humbasë një pjesë të remitancave tradicionale që fëmijët e kanë dërguar në shtëpi.**

Personat me arsim të lartë ose studime pasuniversitare kanë prirje më të theksuar për të ndërmarrë vizita afatshkurtra. Kjo mund të shpjegohet me nivelin më të lartë të të ardhurave që në përgjithësi shkon për krah me nivelin më të lartë të arsimit, duke i lejuar kësaj kategorie të përballojë udhëtimet afatshkurtra në zonën e Shengenit për arsye profesionale ose turizmi.

E njëjta kategori mbetet më e interesuara për të migruar në formë të përhershme, një fakt që tregon se Shqipëria është ende në rrezik për të përjetuar një ikje të trurit. Kjo kategori, siç tregohet dhe në studime të tjera mbi migracionin, gëzon mundësi më të mira punësimi në vendet e destinacionit, një fakt që shton stimujt për të ndërmarrë një vendim migrimi të përhershëm. Diferenca e madhe e pagave që ekziston mes Shqipërisë dhe çdo vendi tjetër të BE-së, si dhe shkëmbimet e intensifikuara akademike dhe kërkimore janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm që ndihmojnë në shpjegimin e prirjes së lartë të shumë njerëzve të kualifikuar për të udhëtuar për afate të shkurtra dhe më pas ndoshta për migrim

të përhershëm.

Mundësia për të lëvizur pa viza, mund të sjellë shpenzimin e kursimeve të qytetarëve me më shumë të ardhura drejt vendeve të Shengenit për udhëtime turistike, kurse formimi, vizita familjare, etj., duke ulur të ardhurat që do të shpenzohen për turizëm në Shqipëri gjatë vitit 2011.

Qytetarët nga qarqet më të zhvilluara nga ana socio-ekonomike, si dhe nga qytetet me flukset më të mëdha të migrimit si p.sh. **Tirana, Durrësi, Elbasani, Vlora dhe Shkodra duket se kanë prirje shumë të lartë për të ndërmarrë vizita afatshkurtra.**

Tregu i varfër i punës gjithashtu duket se ndikon dukshëm në vendimin e qytetarëve për të ndërmarrë vizita afatshkurtra – Qarku i Beratit dhe Kukësit për shembull shfaqin qartë këtë prirje.

Popullsia nga rrethet kufitare me vende të zonës Shengen (Itali dhe Greqi), shënon një **rritje modeste të prirjes për të ndërmarrë vizita afatshkurtra.** Ne supozojmë se këto zona (Korçë, Sarandë, Gjirokastrë) kanë arritur që më parë nivelin e tyre optimal të emigrimit.

Që nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për liberalizimin e vizave (15 dhjetor 2011), drejt zonës Shengen kanë udhëtuar rreth 200 mijë qytetarë shqiptarë. Shqipëria përbën një përjashtim në Ballkanin perëndimor, duke mos shënuar rritje domethënëse të kërkesave për azil. Raporti i Komisionit European mbi Shqipërinë pritet të jetë pozitiv.

Stafi i EuroSpeak



“Koha e artë e fotografisë shqiptare” mbërrin në Bruksel

...vijon nga faqja 1 >> Shumë shpejt, sukcesi i kësaj studioje i kaloi kufijtë e qytetit duke tërhequr të gjithë shoqërinë shqiptare të asaj kohe. Ajo përgatiti disa breza fotografësh të cilët, pas vdekjes së Marubit, morën përsipër të pasqyronin në imazhe historinë dhe jetën lokale. Këta “poetë të dritës”, siç i quan Ismail Kadare, i dhuruan fotografisë shqiptare kohën e saj të artë, e cila u mbyll në vitin 1944, me vendosjen e regjimit diktatorial.

Galeria mbresëlënëse e portreteve është dëshmi nga puna sociale dhe artistike e shoqërisë së asaj kohe. E zbuluar pas një gjysmë shekulli shtypjeje dhe izolimi, kjo punë na tregon sfondin etnologjik dhe aspekte të ndryshme të historisë pak të njohur të Shqipërisë, atë të Shqipërisë osmane, të pavarur, por dhe asaj të pushtuar nga Musolini.

Botanique, mars 2011



Të rinjtë shqiptarë duhet të bëhen pjesë e demokracisë!

...vijon nga faqja 1 >>

bënin shumë premtime, por sapo zgjidheshin bënin komplet gjë tjetër. Slogani shumë atraktiv i fushatës së Tiaos ishte "Votoni majmun – merrni majmun!"

Unë e kam pyetur veten: *Nëse do të isha një i ri shqiptar, a do të merrja mundimin të hidhja votën? A do të kisha besimin se do ia vlente?*

Në fakt, do të dukej shumë e vështirë të gjendeshin arsye për të dalë nga shtëpia në datën 8 maj për të votuar. Thjesht mjafton të lexosh gazetën dhe të dëgjosh shembujt e rasteve të korrupsionit apo abuzimit me pushtetin që të japin një shuplake të mirë në fytyrë. Rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme janë ende të debatuar dhe politikanët e të gjitha kraheve dështojnë të arrijnë një konsensus për mënyrën se si mund të kalohet ky ngërç politik.

Për mëse dy dekada tashmë, Shqipëria është etiketuar si "vend në tranzicion". Sigurisht që kalimi nga regjimi totalitarist (i çdo lloji qoftë), në një demokraci të plotë dhe të pjekur nuk ndodh brenda natës. Në gjithë vendet ish komuniste, tranzicioni ka qenë i gjatë dhe shpesh herë edhe një eksperiencë e dhimbshme. Dhe padyshim Shqipëria ka pasur pjesën e vet të kësaj eksperiencë gjatë viteve nëntëdhjetë. Por deri më sot, kam përshtypjen se ka ardhur koha që të ndalojmë t'i referohemi Shqipërisë si një vend në tranzicion. Në 20 vjet, Shqipëria ka ecur shumë e në shumë drejtime!

Në zgjedhjet e 8 Majit 2011, për herë të parë, do të ketë një gjeneratë të re votuesish të lindur pas rrëzimit të regjimit komunist. A nuk është kjo një mundësi e mrekullueshme për të deklaruar fillimin e një ere të re dhe ndalimin e përdorimit të fjalës "tranzicion" për Shqipërinë?

Duke e kapërcyer konceptin e tranzicionit mund të nënkuptohet edhe fundi i identifikimit të Shqipërisë me të shkuarën e saj. Për një zhvillim dhe progres të vertetë, të ndihmon më shumë të fokusohesh tek ajo që aspiron të arrijë dhe ajo që do të jesh, sesa të përcaktosh se nga vjen. *Kur rri gjithmonë me kokën mbrapa, nuk mund të shohësh atë që ke përpara!*

Prandaj, nëse ne do të pranojmë që gjërat nuk do të përmirësohen vetë, ku qëndron zgjidhja? Unë besoj

se pjesë e zgjidhjes qëndron në procesin zgjedhor. Megjithatë çdo zgjedhje në Shqipëri ka qenë pak më e mirë se e mëparshme, nuk ka arsye për vetë-kënaqësi. Zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2009 mund të jenë cilësuar vërtet si më të mirat, por nuk mund të mohohet se gjithsesi shumë gjëra nuk shkuan siç duhet. Këtë herë Shqipëria duhet të synojë dhe të bëhet e aftë të arrijë standardet ndërkombëtare më të larta.

Por më lejoni që të jem i sinqertë edhe mbi një çështje tjetër: zgjedhjet janë në thelb një mjet dhe jo një zgjidhje, procesi zgjedhor është thjesht një përkthim teknik i një predispozite demokratike. Zgjedhjet nuk janë të lira dhe të ndershme thjesht për shkak të rregullave të lojës, por për shkak të vullnetit të të gjithë atyre që janë të përfshirë në to, si votues ashtu dhe politikanë, për t'i pasur ato të lira dhe të ndershme. Niveli i detajimit të kodit zgjedhor në Shqipëri, sofistikimi i rregullave që menaxhojnë zgjedhjet si dhe debati i vazhdueshëm publik në lidhje me procedurat, janë në fakt e vetmja shprehje e mungesës së besimit ndërmjet aktorëve politikë dhe mungesës së besimit midis politikanëve dhe elektoratit.

Ajo që është më e rëndësishme, domethënë, mungesa e besimit – duhet patjetër të merret parasysh. Prandaj, duhen përpjekje pak më të mëdha për të zbatuar "kontratën" midis publikut dhe politikanëve, midis votuesve dhe të votuarve – kjo mund të ndihmojë sadopak, sepse është shtylla kurrizore e çdo demokracie. Zbatimi i kësaj kontrate kërkon shumë punë dhe përpjekje nga të dyja palët.

Përgjegjshmëria ("të bësh atë që thua") është një parakusht themelor. *Transparenca* ("të thuash atë që bën") është metoda për t'u ndjekur. Dhe *legjitimiteti* është rezultati. Në këtë kuadër, zgjedhjet nuk janë asgjë më shumë edhe asgjë më pak sesa një kontroll i zakonshëm, nëpërmjet të cilit njerëzit, duke rinovuar ose duke ju tërhequr mandatin, sinjalizojnë nëse ata janë të kënaqur me mënyrën në të cilën vendi qeveriset ose nuk qeveriset.

Në një situatë ku kjo "kontratë" midis njerëzve dhe liderëve të tyre nuk zbatohet, nuk ka asnjë alternativë për të zgjedhur ditën e zgjedhjeve. Dhe

kur nuk ka asnjë mundësi zgjedhjeje, ti mund të zgjedhësh edhe një shimpanze. Kjo është diçka që ushqen zhgënjimin dhe indiferencën. Kjo është arsyeja pse të rinjtë i kthejnë kurrizin politikës.

Është shumë e rëndësishme që të rinjtë të kanalizojnë zhgënjimin e tyre drejt një veprimi pozitiv, meqenëse s'ka alternativë tjetër. Ishte Winston Churchill, i cili në një fjalim para Dhomës së Ulët në 1947 tha: "askush nuk pretendon se demokracia është perfekte apo e gjithanshme. Sigurisht, është thënë se demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, përveç atyre formave të tjera që janë provuar herë pas here." Sidomos në Shqipëri, me historinë e komunizmit dhe anarkisë, fjalët e këtij burri duhen mbajtur mend.

Në përfundim, dhe duke ju përgjigjur pyetjes sime të fillimit: PO, unë patjetër që do e hidhja votën time në datën 8 Maj. Sepse është besimi im i fortë se demokracia është shumë e çmueshme për tu injoruar apo braktisur. Dhe pjesëmarrja e plotë e të rinjve është veçanërisht shumë e rëndësishme. Sepse pa votën e të rinjve, asgjë s'ka për të ndryshuar ndonjëherë. Sepse të rinjtë janë liderët e të nesërme.

Shkëputur nga leksioni i Ambasadorit të Vendeve të Ulëta në Shqipëri, SH.T. Z. Van Den Dool, Universiteti F.S. Noli, Korçë, 27 prill 2011

Kartolina nga BE-ja

BE: Koha për të rishqyrtuar pikëpamjet mbi energjinë bërthamore!



Tërmeti dhe cunami shkatërrues që goditën Japoninë më 11 mars 2011 duke shkaktuar një seri shpërthimesh dhe daljen për disa ditë jashtë kontrolli të sistemeve të ftohjes së reaktorëve bërthamorë të Fukushima's, kanë rihapur debatin mbi sigurinë dhe të ardhmen e energjisë bërthamore në Bashkimin Evropian. Pas situatës alarmante të krijuar në Japoni, ministrat e energjisë së vendeve anëtare zhvilluan një takim urgjent në Bruksel më 21 mars në për të diskutuar mbi sigurinë bërthamore dhe ranë dakord që të zhvilloheshin kontrole dhe teste të centraleve në Evropë. Çështja e standardeve të sigurisë për centrale të energjisë bërthamore u shtua gjithashtu me ngut në axhendën e Këshillit Europian të mbajtur në Bruksel në datat 24-25 mars.

Baza për prodhimin e energjisë bërthamore në Evropë filloi të krijohet që në vitin 1957 me lindjen e Komunitetit Europian të Energjisë Atomike (Euratom). Aktualisht, katërmbëdhjetë nga 27 vendet e BE-së kanë centrale bërthamore: Belgjika, Bullgaria, Republika Çeke, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Holanda, Rumania, Sllovakia, Sllovenia,

Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar. Vetëm Franca ka 59 prej 143 centraleve bërthamore të BE-së, të cilat i garantojnë asaj 75% të energjisë, ndërsa Britania e Madhe ka 19, Gjermania 17 dhe Suedia 10 të tilla.

Aktualisht, centralet bërthamore prodhojnë rreth një të tretën e energjisë elektrike dhe 15% të energjisë që konsumohet në Bashkimin Evropian. Vendimi për të ndërtuar apo jo centrale bërthamore i përket çdo shteti në nivel kombëtar, por BE-ja është përpjekur ndër vite që të vendosen disa parametra të përbashkët sigurie.



Konkretisht, në vitin 2009, në gjirin e BE-së u ra dakord për një direktivë mbi sigurinë e centraleve bërthamore, zbatimi i së cilës do të fillojë nga viti 2014. Shtetet anëtare janë të detyruara t'i paraqesin Komisionit çdo tre vjet një raport progresi mbi sigurinë. Ndërkohë, problem mbetet trajtimi i skorieve radioaktive, në lidhje me të cilat po diskutohet një propozim për gruposjen e tyre në thellësitë e nëntokës, propozim mbi të cilin deputetët e PE pritëshin të jepin mendimin e tyre brenda majit 2011.

Ndërkohë, qeveria gjermane ka anoncuar se planifikon t'i mbyllë centralet e këtij vendi brenda vitit 2022. Propozimi, i cili pret akoma të kalojë në hallkat vendimmarrëse, është pritur me entuziazëm nga ambientalistët, por jo nga ekspertët e ekonomisë.

Stafi i EuroSpeak



Frikë e rreme nga punonjësit nga Evropa Lindore

Pengesa e fundit e cila mban shtetasit e tetë vendeve të Evropës Lindore për të hyrë në tregjet e punës së BE-së ra me 1 maj, duke u dhënë atyre lirinë e plotë të lëvizjes. E përditshmja çeke Lidové noviny, shkruan se: "75 për qind e gjermanëve janë të frikësuar se një hordhi e tërë evropianësh lindorë me kërkesa më të ulëta për pagesë do të pushtojë tregun e tyre të punës. Por vëzhgimet e kryera në vendet e Evropës Lindore tregojnë se frika e gjermanëve është e pabazë. Vetëm pak emigrantë do të kërkojnë të punojnë atje dhe shumica e tyre do të jenë punëtorë të kualifikuar, të cilët i mungojnë Gjermanisë me qindra e mijëra.

Frika e gjermanëve se ata do të humbaisn vendet e tyre të punës mund të largohet me një përlllogaritje të thjeshtë matematikore. Të tetë vendet e Evropës Lindore në fjalë kanë rreth 75 milionë banorë në total, ndërsa Gjermania ka 82 milion. Që gjermanët të largohen nga puna e tyre do të duhej që të gjithë njerëzit nga ato vende të zhvendoseshin për në perëndim."

Lidové noviny, 1 mars 2011

Presidenti i Parlamentit Evropian Jerzy Buzek: "tolerancë zero" ndaj korrupsionit mes deputetëve të PE-së

Gjatë hapjes së seancës plenare në Bruksel më 23 mars 2011, Z. Buzek ngriti çështjen e "parave në dorë në këmbim të ndryshimeve legislative", një skandal i publikuar kohët e fundit në një gazetë britanike.

Dy deputetë, austriaku Ernst Strasser dhe slloveni Zoran Thaler, kanë dhënë dorëheqjen, pasi u kapën duke ofruar ndryshime legislative në këmbim të pagesave nga një firmë e rreme lobiste. Një deputet i tretë i implikuar në këtë skandal, rumuni Adrian Severin - është përjashtuar nga grupi i tij parlamentar dhe tani qëndron si i pavarur, megjithëse ka pasur thirrje të shumta për dorëheqje.

Jerzy Buzek deklaroi se do të vëzhgojë rreptësisht që të ruhet "ndershmëria e parlamentit", edhe pse sipas deputetit të pavarur austriak Hans-Peter Martin, mund të ketë shumë deputetë të tjerë të implikuar.

BBC – Democracy live, 25 mars 2011

Kërkesa për rinacionalizimin e Shengenit dhe propozimi i Komisionit Evropian në përgjigje të kësaj kërkesë



Disa vende anëtare të BE – së kanë mbështetur përpjekjet e Francës dhe Italisë për ri-vendosjen e kontrollin kufitar, pas fluksit të emigrantëve nga Afrika veriore. Gjermania, Holanda, Greqia dhe Malta i kanë dhënë bekimin e tyre thirrjes së Parisit dhe Romës për disa ndryshime të Marrëveshjes së Shengenit, ndërsa kanë nënvizuar rëndësinë e një "Europe të hapur". "Nëse ju mund të përmirësoni sistemin e Shengenit, kjo është pozitive dhe duhet bërë". Por, liria e udhëtimit në Evropë, është një arritje kaq e rëndësishme sa që nuk mund të ri-negociohet" - ka pohuar Ministri i Jashtëm Gjerman Guido Westerwelle.

Malta dhe Greqia theksuan nevojën që shtetet e tjera anëtare të tregojnë "solidaritet" me vendet jugore të BE. Malta është stacioni i parë për emigrantët nga Afrika, ndërsa Greqia është duke luftuar për të siguruar kufijtë me Turqinë. "Shpresoj që rishikimi i traktatit të Shengenit nuk nënkupton krijimin e mureve dhe portave, por një lëvizje drejt solidaritetit," - tha zëvendëskryeministri i Maltës.

Tensioni është intensifikuar më shumë në javët e fundit kur Italia u përball me një fluks të madh emigrantësh,

kryesisht Tunizianë, aq sa ajo vendosi dhënien e lejeve të qëndrimit të përkohshëm. Shumë prej emigrantëve filluan të shkojnë në Francë, e cila reagoi duke mbyllur kufijtë e saj për ta.

Në takimin e mbajtur më 26 Prill 2011, Presidenti Francez Nikolas Sarkozy dhe Kryeministri Italian Silvio Berlusconi dolën me një deklaratë të përbashkët e cila parashikonte ri-vendosjen e kontrollit kufitar në rrethana të jashtëzakonshme. Një kërkesë e tillë do të kërkonte ndryshimin e filozofisë së Shengenit nga një besim dhe solidaritet reciprok në një mosbesim reciprok.

Komisioni Europian në një komunikim më 4 Maj, në përgjigje të kësaj letre e cila kërkonte "Rinacionalizimin e Shengenit", propozoi shtimin e mundësive për rivendosjen e kontrollit të brendshëm kufitar. Ky kontroll parashikohej në

dy raste: 1) kur një shtet anëtar i BE nuk plotëson detyrimin për të kontrolluar kufijtë e jashtëm 2) kur kufijtë e jashtëm janë nën një presion të madh dhe të paparashikueshëm.

Aktualisht, rregullat lejojnë vendet anëtare të BE-së të vendosin kontrollin kufitar në rastin e një rreziku ndaj rendit publik dhe sigurisë së brendshme, e cila mbetet një çështje kombëtare e shteteve anëtare. Ndërkohë që në rastin e dy situatave të parashikuara më lart, menaxhimi i kufijve të jashtëm duhet bërë në nivel Europian. Rivendosja e kontrollit kufitar është instrumenti i fundit i BE – së i cili mund të përdoret vetëm atëherë kur të gjitha instrumentet e tjerë janë ezauruar.

Propozimi i Komisionit dot'ikalojë për vendimarrje Këshillit dhe Parlamentit Europian për ta aprovuar ose refuzuar atë.

Stafi i EuroSpeak



Me jeshile: Vendet ku popullsia është në rritje
Me të kuqe: Vendet ku popullsia është në ulje

Jetëgjatësia e Europianëve rritet me 2-3 muaj në vit ndonëse popullsia bullgare tkurret në nivele alarmante

Jetëgjatësia mesatare e popullsisë së BE-së është duke u rritur me 2-3 muaj çdo vit. "Por

një rritje e tillë modeste nuk do të jetë e mjaftueshme për të parandaluar rënien e përgjithshme të popullsisë nga 2050 e tutje" shkruhet në një raport të ri demografik të BE-së. "Jetëgjatësia është rritur ndërsa fuqia punëtore në Europë është duke u pakësuar dhe në disa shtete anëtare, kjo po ndodh shumë shpejt" – pohoi Komisioneri i BE-së për çështjet sociale, Laszlo Andor.

EU Observer, 1 prill 2011

Regjistrimi i popullsisë në Bullgari ka zbuluar se gjatë 10 vjeçarit të fundit, vendi ka humbur 582,000 njerëz dhe se popullsia po plakët shpejt. Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, arsyeja kryesore e rënies demografike nuk është emigracioni, por fakti që normat e lindjes janë më të vogla se normat e vdekshmërisë. Midis vendeve të tjera në botë, Zimbabve ka një normë të shpopullimit të krahasueshme me Bullgarinë. Sipas statistikave të BE, rezulton se Bullgaria ka normat më të larta të zvogëlimit natyror të popullsisë -0,79% në vit.

Ajo ndiqet nga Estonia (-0,63%), Letonia (-0,61%), Lituania (-0,27%), Hungaria (-0,25%), Rumani (-0,14%), Sllovenia (-0,11%), Republika Çeke (-0,09%), Gjermania (-0,05%), Polonia dhe Italia (-0,04%).

EurActiv, 6 prill 2011

Në pritje të aderimit...



Mosmarrëveshje gjithnjë e më të thella

Mosmarrëveshjet ndëretnike në Bosnje - Hercegovinë vazhdojnë, duke prekur tashmë edhe një aspekt i cili tradicionalisht i bashkon popujt: futbollin. Në datën 1 prill, Federata e Futbollit e Bosnje - Hercegovinës është pezulluar deri në një vendim të mëtejshëm nga FIFA dhe UEFA. Kjo do të thotë se për momentin, ekipet e Bosnje - Hercegovinës nuk do të mund të marrin pjesë në garat dhe aktivitetet ndërkombëtare.

Vendimi ka qenë i pashmangshëm pasi Federata, e përçarë thellë mbi baza etnike, nuk ka arritur ta modifikojë statutin sipas kërkesave të dy autoriteteve të lartpërmendura. Asambleja e Federatës në fjalë nuk ka arritur të sigurojë kuorumin e mjaftueshëm për ndryshimin e statutit në mbledhjen e saj të datës 29 mars, ku vetëm 22 nga 54 delegatët e pranishëm votuan në favor të ndryshimit të statutit. FIFA dhe UEFA kanë shprehur keqardhjen për këtë vendim të pashmangshëm nga ana e tyre dhe kanë uruar që Federata boshnjake t'i ribashkohet aktiviteteve ndërkombëtare të futbollit sa më parë.

BE paralajmëron Kroacinë para mbylljes së negociatave

Komisioni Europian i bëri thirrje qeverisë kroate që të rrisë përpjekjet e saj për reforma në fushën e drejtësisë, krimeve të luftës si dhe luftën kundër marrjes së ryshfetit në qoftë se dëshiron që negociatat të përfundojnë në qershor.

Një raport nga shoqëria civile në Kroaci, pohon se përfundimi i bisedimeve në Qershor është i mundshëm, ndonëse reformat serioze mbeten ende për tu ndërmarrë. Në këtë raport si problem serioz evidentohet "klientelizmi", në ligjin për fushat e golfit miratuar në 2009, i cili heq të drejtat e pronësisë, favorizon vetëm një lloj investimi dhe stimulon korrupsionin në fushën e planifikimit hapësinor në nivelet e pushtetit lokal."

Pavarësisht nga fakti se shumica e kritereve kërkojnë më shumë se katër muaj për t'u përfunduar, zyrtarët e BE-së hodhën poshtë idenë e një mekanizmi monitorimi post anëtarësimit siç ndodhi me rastin e Rumanisë dhe Bullgarisë në 2007. "Qëndrimi ynë është i qartë: nuk ka mekanizëm monitorimi," u pohua nga një burim i besueshëm i BE-së, duke theksuar se gjërat kanë ndryshuar që nga koha e negociatave me dy shtetet e lartpërmendura.

"Unë nuk mund të flas për një datë të caktuar. Ne e kemi theksuar gjithmonë se përmbajtja është më e rëndësishme se shpejtësia," tha Presidenti i Komisionit Europian Barroso në një konferencë shtypi pas bisedimeve me kryeministren kroate Jadranka Kosor. Duke e përshkruar pranimin e ardhshëm të Kroacisë në BE si një "katalizator" për këtë rajon, Barroso tha se perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor mbetet e lartë në axhendën e BE-së dhe se turneu i tij i fundit në rajon e riafirmoi këtë angazhim.

Stafi i EuroSpeak

Serbia kthen investitorët e BE-së në "kokë turku"

Investitorët nga BE-ja duket se po paguajnë një çmim për vështirësitë ekonomike apo politike në Serbi, vend i cili ka aplikuar zyrtarisht për anëtarësim në Bashkimin Europian. Komisioni Europian dhe Parlamenti po vëzhgon nga afër zhvillimet, ku shembujt e kohëve të fundit tregojnë rreziqet e vazhdueshme që u kanosen investitorëve të huaj. Përvoja e një kompanie holandeze është ekspozuar së fundmi në Bruksel si shembull i vështirësive të vazhdueshme me të cilat përballen investitorët e huaj në vendin ballkanik. Në një klimë të vështirë politike dhe ekonomike Komisioni i Konkurrencës në Serbi i ka vendosur kompanisë DFG (e cila ofron prodhime bulmeti) një gjobë prej rreth 3 milionë eurosh për abuzim me pozicionin dominues në treg. Një rast tjetër i paraqitur në Bruksel ka të bëjë me mbajtjen në burg prej më shumë se 8 muajsh pa marrë një dënim të Tomislav Gjorgjeviç, një sipërmarrës serb dhe qytetar britanik që kishte

blerë një kompani të peshkimit dhe që akuzohet për vjedhje. Megjithatë, mësohet gjithashtu se përpara se të vihej në shënjestër nga sistemi gjyqësor serb, Gjorgjeviq kishte provuar të hedhë në gjyq shtetin për problemet që ai kishte hasur në një marrëveshje privatizimi. Sipas eurodeputetit liberal slloven Jelko Kacin, raportues i Parlamentit Evropian për Serbinë: “është alarmuese që një numër i madh biznesesh janë ankuar në lidhje me ndërhyrjet e qeverisë që nga fillimi i krizës ekonomike”. Ai shtoi se “është e nevojshme që organet rregullatore të jenë të pavarura nga zyrtarët e shtetit dhe manjatët serbë dhe të gjitha kompanitë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë nga qeveria”.

Serbia është jashtëzakonisht e varur nga marrëdhëniet tregtare me BE-në. Sipas statistikave të BE-së, më shumë se gjysma e tregtisë së Serbisë në mallra bëhet me BE-në, me vlerë deri në 11.5 miliardë euro, ndërkohë që Prodhimi Total i Brendshëm i Serbisë është rreth 29.4 miliardë euro. Investimet e drejtpërdrejta të BE-së në Serbi në vitin 2008 arrinin në 1.5 miliardë euro.



Kosova ndërron presidentët në një kohë rekord. Forcohet roli i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Kosovës publikoi me 30 mars 2011 vendimin e plotë në të cilin ajo e shpall jo kushtetuese zgjedhjen e presidentit të Kosovës Behgjet Pacolli. Në vendim thuhet se zgjedhja e Behgjet Pacollit në postin e presidentit pa asnjë kandidat konkurent paraqet shkelje të nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës, ndërsa jo kushtetuese vlerësohet edhe mungesa e kuorumit në kohën e votimit në seancën e 22 shkurtit, ku nuk kishte kuorum prej dy të tretave të deputetëve të Parlamentit, në kohën kur u mbajt raundi i parë dhe i dytë i zgjedhjes së presidentit. Votimi u bë me 67 deputetë të pranishëm në sallën e Parlamentit ndërsa zgjedhja e Z. Pacolli, kandidati i vetëm, u krye në raundin e tretë. Presidenti Pacolli, i cili kishte paralajmëruar se

do të veprojë në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është larguar nga zyrat e tij, ndërsa fillimisht paralajmëroi se do të rikandidohet nëse do të ketë një rivotim për postin e presidentit.

Zëri i Amerikës, 30 mars 2011

Më 8 prill, Parlamenti i Kosovës zgjodhi Atifete Jahjagën si presidenten e saj të re, duke i dhënë fund mosmarrëveshjeve mes partive politike mbi postin e presidentit.

Jahjaga, gruaja e parë në krye të shtetit ishte një kandidate kompromisi, e propozuar me ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara për të gjetur një marrëveshje mes të kryeministrit Hashim Thaçi, biznesmenit Pacolli dhe kreut të opozitës, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa.

Jahjaga do të jetë presidente e Kosovës për një periudhë rreth një vjeçare, pasi shumë shpejt, zgjedhja për këtë post të lartë në Kosovë do të bëhet nëpërmjet referendumit kombëtar. Përtej polemikave dhe ndërrimit në një kohë rekord të presidentëve, ngjarja mund të shihet si një sinjal pozitiv për konsolidimin e Gjykatës Kushtetuese në Kosovë dhe zbatimin rigoroz të vendimeve të saj.

Stafi i EuroSpeak

Krerët e institucioneve të BE-së: Udhëheqësit politikë duhet të jenë në lartësinë e aspiratave evropiane të Shqipërisë

Ne kemi mbajtur shënim bërjen publike nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të rezultatit për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë së Tiranës. Megjithatë ne kemi mbajtur shënim që çështja e llogjikës ligjore të vendimeve të KQZ-së, për të numëruar të ashtuquajturat vota “të hedhura gabimisht”, është një çështje që përbën shqetësim. Procesi zgjedhor nuk ka përfunduar ende. Bashkimi Evropian do të ndjekë nga afër plotësimin e procedurave të apelit dhe publikimin e rezultateve përfundimtare si dhe vlerësimin e procesit nga misioni i monitorimit të zgjedhjeve të OSBE/ODHIR.

Bashkimi Evropian pret që procedurat e apelimit



të jenë të ndershme, transparente dhe të mbahen në mënyrë të pavarur dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor ekzistues.

Zgjidhje konsensuale dhe të qëndrueshme mund të gjenden për ato çështje të cilat nuk janë mbuluar në mënyrë eksplicite nga ligji dhe që kërkojnë interpretim. Për këtë qëllim, partitë duhet të nisin menjëherë dialogun në mënyrë që të bien dakort se si ta trajtojnë çështjen e votave "të hedhura gabimisht". Një mundësi që mund të merret në konsideratë është që të kërkohet këshillim nga jashtë i pavarur për vendimet e debatuar të KQZ-së.

Interesi i vendit dhe vazhdimësia e procesit të integritimit evropian duhet të mbizotërojë para interesave partiake. Udhëheqësit politikë duhet të jenë në lartësinë e aspiratave evropiane dhe demokratike të qytetarëve shqiptarë.

Nga deklarata e përbashkët mbi Shqipërinë e Catherine Ashton, Përfaqësuese e Lartë e BE-së dhe Stefan Fule Komisioneri për Zgjerimin, 24 maj 2011

BE do të lejojë pezullimin e përkohshëm të regjimit pa viza

Komisioni Evropian njoftoi më 24 maj se do të pezullojë përkohësisht vendet nga lista e heqjes së vizave në qoftë se ka një rritje të papritur në aplikimet për azil ose qëndrim të paligjshëm. Sipas Komisioneres për çështjet e brendshme, Cecilia Malmstrom, të ashtuquajturat masa mbrojtëse "do të bëjnë politikën e vizave më efektive dhe të na lejojnë që të reagojmë ndaj ngjarjeve të paparashikuara".

Një vend anëtar i BE-së do të duhet të provojë se ai ka një fluks të madh shtetasish me qëndrim të paligjshëm nga një vend, çka do të thotë më shumë se 50 % gjatë një periudhe gjashtë-mujore që pezullimi të aktivizohet.

E njëjta gjë do të zbatohet në qoftë se shteti anëtar dëshmon se ka rritje me më shumë se 50 % të kërkesave për azil në 6 muaj nga një vend ku kërkesat për azil janë zakonisht nën 3%. Një mundësi e tretë për futjen e masës do të ndodhë kur të kërkesave të ripranimit rritet me mbi 50 % gjatë një periudhe gjashtë-mujore, në krahasim me vitin e mëparshëm. Malmstrom këmbënguli se kjo do të jetë vetëm një masë "resursi i fundit", dhe se nuk ka për qëllim të vërë asnjë vend të veçantë në shënjestër. Por ajo

përmendi Serbinë dhe Maqedoninë, si dhe dialogun e Komisionit me to mbi mënyrën se si do të trajtohet problemi i mijëra shtetasve të tyre që kërkojnë azil në vendet e BE-së.

Ky vendim është reagim ndaj iniciativës së Belgjikës, mbështetur nga Gjermania për të kërkuar zgjidhjen e problemit të lartpërmendur të kërkesave për azil të qytetarëve serbë dhe maqedonas, qoftë dhe nëpërmjet pezullimit të lëvizjes pa viza.

EU Observer, 24 maj 2011

Turqia dhe e ardhmja e BE-së

Cili është qëllimi i ekzistencës së BE-së sot? Që të na pengojë ne të luftojmë ndaj njëri – tjetrit? Sigurisht që ne nuk do të luftojmë. Qëllimi moral i Europës sot është një pyetje ekzistenciale që të gjithë evropianët duhet ta marrin në konsideratë.

Për mua, përgjigja duhet gjendur tek Turqia. BE-ia me Turqinë si anëtare të saj natyrshëm do të ishte një ekonomi më dinamike. Turqia është një qendër rajonale e energjisë. Ajo ka pushtet dhe respekt në rajonin e vet përmes forcave të saj ushtarake. Dhe, mbi të gjitha, Turqia tani është një model për shoqëritë e tjera islamike të cilat përpiqen të përshtatin demokracinë, liritë civile, sundimin e ligjit, një ekonomi tregu dhe pluralizmin e feve në vendet e tyre.

Si një shtet anëtar i BE-së, Turqia do të mund të shtonte një dimension të ri të një rëndësie historike. Evropianët do të dëshmonin se ata mund të përqafojnë një demokraci islamike dhe ndërtojnë ura të fortë mes Europës dhe Azisë perëndimore.

Kjo, nga ana tjetër, do të krijojë një identitet të ri evropian dhe një arsye të re për ekzistencën e BE-së në këtë shekull, një mënyrë për të hedhur poshtë politikën e vjetër përçarëse. Unë shpresoj që në kohën që unë të marr pendën për të rishkruar përsëri, ne do të jemi në rrugën tonë për këtë destinacion. Nëse jo, atëherë shumë prej nesh do ta kenë gjithnjë e më të vështirë ta shohin BE-në si diçka më shumë se thjesht një bashkim doganor me ambicie politike që janë shumë të mëdha për mundësitë e saj.

Chris Patten, ish Komisioner për Marrëdhëniet me Jashtë, 1999 - 2004



Jürgen Habermas mbi projektin evropian

Procesi i unifikimit të Europës po vihet në diskutim për shkak se elitat politike nuk janë të angazhuara në mbështetje të rritjes së përfshirjes të qytetarëve, shkruan filozofi gjerman Jürgen Habermas. “Për sa kohë që qytetarët evropianë shohin vetëm qeveritë e tyre kombëtare si lojtarë në skenën Europiane, ata do t’i perceptojnë proceset e vendim-marrjes si lojë me vetëm një fitues në të cilën lojtarët e tyre duhet të mbizotërojnë mbi të tjerët . Është mjaft e mundshme që të jetë i saktë parashikimi që vendet e lodhura me Europën do të kundërshtojnë transferimin e mëtejshëm të sovranitetit edhe brenda pjesës së konsideruar si thelbi i BE-së. Por ky parashikim është një justifikim i përshtatshëm për elitat politike që të shmangin pjesën e tyre të përgjegjësive mbi gjendjen e tanishme për të ardhur keq të BE-së. Procesi i unifikimit Europian, i cili gjithmonë është çuar përpara mbi kokat e qytetarëve, tani ka arritur në një qorrsohak, sepse nuk mund të shkojmë më tutje pa u konvertuar, nga mënyra aktuale e administrimit, tek një tjetër që përfshin pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve të Europës. Elitat politike kanë groposur kokat e tyre në rërë, ata janë duke vazhduar projektin e tyre elitare dhe paaftësimin e qytetarëve të Evropës.”

Süddeutsche Zeitung, 8 prill 2011

EuroSpeak është një revistë e përdymuajshme, e pasur me informacion të përditësuar dhe analiza mbi çështje të integritimit evropian, me fokus të veçantë mbi zhvillimet e marrëdhënies të BE-së me Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit. Nga vetë emri, EuroSpeak (gjuha e përdorur nga burokratët në Bruksel dhe shpeshherë e kuptueshme vetëm për ekspertët), revista është projektuar për të përcjellë tek publiku i gjerë në një gjuhë më të lexueshme dhe jo teknike thelbin e debateve në gjirin e institucioneve të BE-së. Ajo synon të zvogëlojë hendekun aktual informativ mbi tema të tilla duke aspiruar të propozojë analizë cilësore dhe të pavarur e cila shkon përtej listimit të thatë të fakteve apo deklaratave të politizuara mbi integritimin në BE që ndeshen shpesh në media.

Përmbledhjet apo ekstraktet e artikujve publikohen në zbatim të Ligjit Nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me Të”.

Për më shumë informacion mbi aktivitetet dhe publikimet e fundit të EMA-s, vizitoni faqen tonë të re www.em-al.org

Lëvizja Europiane në Shqipëri është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritimit evropian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritimit evropian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritimit evropian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave evropiane si dhe i procesit të integritimit evropian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritimit evropian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Për komente, sugjerime ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org



Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.